



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

DREJTËSIA NË BUXHETIN E VITIT 2023

Analizë krahasuese me vitin 2022

17 NËNTOR 2022, PRISHTINË

Përmbajtja

1.Hyrje

2. Ndarjet buxhetore për institucionet e Sektorit të Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë

2. Këshilli Prokurorial i Kosovës

3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës

4. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

Hyrje

Në mbledhjen e 103-të, Qeveria e Kosovës e miratoi Projektligjin për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, shpenzimet e së cilit kapin vlerën prej 3 miliardë e 212 milionë euro. Projektligji i është proceduar Kuvendit të Kosovës, i cili pritet ta diskutojë dhe miratojë sipas procedurave të parapara me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Këtë vit, ndarjet buxhetore shqyrtohen me procedurë të veçantë në raport me projektligjet e tjera. Pozitive në raport me trajtimin e projektligji mbi ndarjet buxhetore të buxhetit vjetor nga ana e Kuvendit do të jetë përfshirja e të gjitha komisioneve parlamentare për shqyrtimin e tij përkitazi me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre mbikëqyrëse. Ato do ta shqyrtojnë buxhetin sipas fushave që mbulojnë dhe në kohën kur shqyrtohet buxheti merr pjesë edhe ministri përkatës dhe përfaqësuesit e tjerë të organizatave buxhetore. Me rregulloren paraprake, trajtimi i tillë i buxhetit ka qenë vetëm në vullnetin e komisioneve përkatëse. Krahësuar me buxhetin e vitit paraprak, planifikimi i të hyrave dhe i shpenzimeve do të jetë më të lartë në vlerë monetare. Të hyrat janë planifikuar të rriten për 453.7 milionë euro ndërsa shpenzimet janë planifikuar të rriten për 313.5 milion euro.

Viti	2022	2023
Të hyrat e parashikuara	2,430.4 €	2,884.10 €
Shpenzimet e planifikuara	2,898.2 €	3,211.7 €

Tabela 1. Të hyrat e parashikuara dhe shpenzimet e planifikuara,
shprehur në milion Euro.

Burimi: Tabela 1 dhe 1.1 e e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe projekligjit mbi ndarjet buxhetore të buxhetit për vitin 2023

Projektligji për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, I pranuar në Kuvendin e Kosovës me dt. 31.10.2022 dhe i shpërndarë tek deputetët me dt. 01.11.2022, I qasshëm nga:

https://ëëë.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/193PLmbindarjetbuxhetoreperBuxhetineKosoves2023_5Td6g6q8t2.pdf

Ligji nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, I publikuar në Gazetën Zyrtare me dt. 31.12.2021, I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51763>

Sipas projektligjit tashmë të dërguar në Kuvendin e Kosovës për vitin 2023, shumica e të hyrave do të jenë nga të hyrat tatimore, të hyrat jo tatimore dhe të hyrat nga grantet.

Të hyrat tatimore	2,525.4 €
Të hyrat jo tatimore	261.2 €
Grantet	97.5 €
Total	3,211.7 €

Tabela 2: Parashikimi i Qeverisë për të hyrat tatimore, jo tatimore dhe grantet, shprehur në milion Euro.

Burimi: Tabela 1 dhe 1.1 e e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe projektligjit mbi ndarjet buxhetore të buxhetit për vitin 2023

Nga ana tjetër bazuar në projekt ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2023 shpenzimet janë planifikuar të jenë në shumën prej 3 miliardë e 211 milionë euro, pjesa dërrmuese e së cilave do të jetë për shpenzimet rrjedhëse. Nga to 2.342 miliardë euro për paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, dhe rezerva rrjedhëse. Shpenzimet kapitale do të mbërrijnë në 810 milionë euro, të cilat do të financohen nga buxheti i rregullt dhe klauzola e investimeve.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve gjatë prezantimit të projektligjit ka treguar se parashikimet dhe supozimet makro-fiskale për buxhetin për vitin 2023 bazohen në kornizën e azhurnuar makrofiskale 2023-2025, dhe për qëllime informimi përshkrimi i tyre është bashkangjitur në shtojcën 1 të ligjit, së bashku me treguesit e performancës, që janë bashkangjitur në shtojcën 2.

Ndarjet buxhetore për institucionet e Sektorit të Drejtësisë

Në këtë pjesë paraqiten ndarjet buxhetore për institucionet si më poshtë:

- 1. Ministria e Drejtësisë;
- 2. Këshilli Gjyqësorë i Kosovës;
- 3. Këshilli Prokurorial i Kosovës; dhe,
- 4. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Sipas shtojcës 1 nga buxheti vjetor prej rreth 2,492,504,804 euro për vitin 2023 për të gjitha institucionet, pjesëmarrja totale në buxhet e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit përbën 3,47 % e këtij buxheti. Pjesëmarrja në buxhetin e vitit 2022 ishte 3,7 %.

Viti	2022	2023
Ministria e Drejtësisë	29,621,039.00 €	35,945,052.00 €
Këshilli Prokurorial i Kosovës	17,144,178.00 €	15,913,983.00 €
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	32,183,896.00 €	34,155,572.00 €
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	545,778.00 €	557,844.00 €
Buxheti total	79,494,891.00 €	86,572,451.00 €

Tabela 3. Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe për vitin 2023

Burimi: Shtojca 1. Buxheti për vitin 2022/Vlerësimet për vitet 2023-2024 dhe Shtojca 1. Buxheti për vitet 2023-2025

Nëse e marrim për bazë totalin e shpenzimeve të parashikuara prej 3,212 miliardë euro, për vitin 2023, atëherë pjesëmarrja e katër institucioneve përbën 2.7% e shpenzimeve të buxhetit. Pjesëmarrja në buxhetin e vitit 2022 në raport me shpenzimet e planifikuara ishte 2,9 %.

Viti	2022	2023
Buxheti total i shpenzimeve	2,748,000,000 €	3,211,700,000 €
Ministria e Drejtësisë	29,621,039 €	35,945,052 €
Këshilli Prokurorial i Kosovës	17,144,178 €	15,913,983 €
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	32,183,896 €	34,155,572 €
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	545,778.00 €	557,844.00 €
Pjesëmarrja në shpenzime	2,9%	2,7 %

Në projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin për vitin 2023, ne faqen 676 në pjesën tekstuale Qeveria ka treguar se misioni i saj do jetë që të përpilojë politika publike, akte ligjore dhe nënligjore dhe standarde të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi si dhe të sigurojë sistem të pavarur, të paanshëm profesional dhe efektiv të sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

Njëmbëdhjetë objektiva janë vendosur në kuadër të sektorit të Rendit, Ligjit dhe Sigurisë Publike, ku për çështje të drejtësisë është vënë theksi te rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, vetingu në sistemin e drejtësisë, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, adresimi i krimeve kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, , ngritja e vetëdijes së qytetarëve për shërbimet që ofrohen nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së prokurorive dhe gjykatave me qëllim të plotësimit të nevojave që dalin nga reforma gjyqësore.

Në programin qeverisës të Lëvizjes Vetëvendosje, me të cilin program kjo parti kishte garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, premtohet mbështetje financiare për sistemin e drejtësisë. Kjo, kryesisht, me qëllim të rritjes së kapaciteteve humane dhe profesionale në sistemin e drejtësisë.

Ky premtim është bërë në vazhdimësi edhe pasi VV-ja ka marrë pushtetin.

Fillimisht duhet theksuar faktin se mungesa e rezultateve të sistemit të drejtësisë nuk është vetëm si pasojë e mungesës së resurseve financiare për këtë sektor. Siç e kemi thënë vazhdimisht, mungesa e rezultateve të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë ndërlidhet me mungesën e vullnetit për të luftuar këto dukuri kriminale. Por, mungesa e resurseve financiare është domosdoshmërisht njëra prej arsyeve të mungesës së efikasitetit.

Fillimisht, duhet të theksojmë faktin se për ngritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë nuk është i mjaftueshëm vetëm ngritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Krahas ngritjes së numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve kërkohet domosdoshmërisht edhe staf i mjaftueshëm mbështetës, në mënyrë që gjyqtarët dhe prokurorët të kenë mundësi që punën e tyre ta kryejnë në mënyrë efikase.

Sipas Ligjit, secili gjyqtar dhe prokurorë duhet ta ketë nga një bashkëpunëtorë profesional. Ky obligim ligjor ende nuk është përmbushur në plotëni, për shkak të mungesës së buxhetit të mjaftueshëm për KGJK dhe KPK. Për më tepër, ne gjatë monitorimit shohim se ka gjyqtarë të cilët përpos se nuk kanë bashkëpunëtorë profesional nuk kanë as zyrtarë ligjor. Kështu, krahas gjykimit të rasteve, të njëjtit obligohen që të kryejnë edhe të gjitha punët e tjera administrative dhe rrjedhimisht bie edhe efikasiteti i gjyqtarit. E gjithë kjo ndodhë për faktin se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të rekrutuar mjaftueshëm staf për sistemin e drejtësisë. Po ashtu, ka edhe obligime të tjera të cilat në mungesë të resurseve financiare nuk mund të zbatohen nga KGJK dhe KPK. Marrim shembull transparencën. Sipas ligjit, gjykatat obligohen që brenda 60 ditëve të publikojnë të gjitha aktgjykimet e plotfuqishme. Ndonëse ka një progres të konsiderueshëm në këtë drejtim, zbatimi i këtij obligimi ligjor sfidohet nga mungesa e stafit, e cila mungesë vë në rezultat i pamjaftueshërisë financiare për të rekrutuar pozita të reja. Mbi të gjitha këto nevoja, projekt buxheti për vitin 2023 nuk tregon progres të kënaqshëm në këtë drejtim dhe duket se nuk e ka fokus ngritjes e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë, përkundër faktit se ky buxhet konsiderohet si buxheti më i madh që ka pasur Kosova deri tash.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, ka planifikuar të ketë buxhet për vitin 2023 në shumën prej 35,945,052 euro, i cili në raport me buxhetin paraprak vjetor i bie të ketë një rritje në normë monetare prej 6,324,013 euro. Ndër tjera, rritjes së buxhetit i ka kontribuar edhe procesi i racionalizimit të agjencive të pavarura nën ombrellën e institucioneve Qeveritare, dhe si rrjedhojë Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është vendosur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë bashkë me buxhetin e saj në shumën prej 444,170 euro. Po ashtu, rritje vërehet tek subvencionet dhe transferet për 2,820,000 euro më shumë, shpenzimet komunale do të rriten për 210,800 euro, shpenzimet kapitale do të rriten për 184,000 euro përderisa tek rezervat nuk është paraparë asnjë shumë monetare.

Të dhënat e paraqitura tregojnë për rritje të numrit të punëtorëve për 64 ku në këtë rritje bën pjesë edhe stafi prej 36 punëtorë të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Viti	2022	2023
Buxheti Vjetor	29,621,039	35,945,052
Të punësuarit	1,992	2,056
Paga dhe shtesa	14,020,165	14,541,948
Mallëra dhe Shërbime	6,286,905	8,884,335
Shpenzimet Komunale	1,053,969	1,264,769
Subvencione dhe transfere	6,928,000	9,748,000
Shpenzimet kapitale	1,322,000	1,506,000
Rezervat	10,000	0

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Në buxhetin e propozuar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shpenzojë 34,155,572 euro, e që në krahasim me vitin paraprak i bie një rritje prej 1,971,676 euro. Kjo rritje është reflektuar tek pagat dhe mëditjet në shumën prej 611,431 euro duke pasur parasysh që do të ketë një rritje të stafit nga 2,271 sa ishin në vitin 2022, tani në 2,321 në vitin 2023, pra një rritje prej 50 punëtorë. Mallrat dhe shpenzimet do të rriten për 444,495 euro më shumë dhe shpenzimet kapitale për 910 mijë euro më shumë. Subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet komunale do të mbesin të njëjta.

Sa i përket investimeve kapitale, shuma prej 3,130 milionë euro është destinuar për dizajnimin dhe ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të gjykatave, dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren, dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës themelore në Gjilan/Dega në Viti, dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Drenas, ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtime, renovimi i objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të Jugut dhe dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Arkivit Qendror të Gjykatave dhe Gjykatës Supreme.

Viti	2022	2023
Buxheti Vjetor	32,183,896	34,155,572
Të punësuarit	2,271	2,321
Paga dhe shtesa	25,086,141	25,697,572
Mallëra dhe Shërbime	3,983,505	4,428,000
Shpenzimet Komunale	394,250	400,000
Subvencione dhe transfere	500,000	500,000
Shpenzimet kapitale	2,220,000	3,130,000
Rezervat	0	0

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës do të pësojë zvogëlim të shpenzimeve. Të dhënat e prezantuara në faqen 78 dhe tek Shtojca 1. Buxheti për vitin 2023 tregojnë se ulja e buxhetit për KPK-në do të jetë për 1,230,195 euro. Reduktimi i buxhetit për KPK-në në vitin 2023 vërehet tek shpenzimet kapitale, nga 3,364,500 euro sa ishin në vitin 2022, tani në këtë kategori buxhetore janë planifikuar të shpenzohen 1,489,000 euro, e që i bie një ulje prej 1,875,500 euro. Rritje të buxhetit do të ketë për kategorinë paga dhe mëditje, ngase do të rritet numri i punëtorëve për 26, kështu rritja e shumës buxhetore do të bëhet për 611,431 euro. Rritje prej 44,495 euro do të ketë edhe për kategorinë mallra dhe shërbime.

Shuma prej 1,489,000 euro tek shpenzimet kapitale do të përfshijë furnizimin dhe Instalimin me UPS qendror, sistemin elektronik për menaxhimin e rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të viktimave, sallën e konferencës të KPK-së, pajisjet harduerike dhe softuerike të teknologjisë informative, instalimin e Sistemit të Sigurisë kundër zjarrit në arkiva, blerjen e tokës për PTH Mitrovicë, ndërtimin dhe përmirësimin e Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial, sistemin e menaxhimit të ndërtesave, dizajnimi dhe furnizimi me mobile për KPK dhe PSRK dhe sistemin elektronik për menagjimin e dokumenteve dhe takimeve të KPK-së (E-Këshilli).

Viti	2022	2023
Buxheti Vjetor	17,144,178	15,913,983
Të punësuarit	938	964
Paga dhe shtesa	11,184,231	11,505,353
Mallëra dhe Shërbime	2,375,817	2,720,000
Shpenzimet Komunale	199,630	199,630
Subvencione dhe transfere	0	0
Shpenzimet kapitale	3,364,500	1,489,000
Rezervat	20,000	0

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2023 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit do të mbetet i njëjtë me shpenzimet buxhetore të vitit 2022, përveç të një rritjeje të vogël buxhetore prej 12,066 euro. Rritje prej 10,000 euro do të reflektohet në masë të madhe për investimet kapitale ndërsa pjesa tjetër tek pagat dhe mëditjet në shumën prej 2,066 euro.

Sipas të dhënave në projektbuxhet, shihet se numri i punëtorëve do të jetë i njëjtë, e po ashtu edhe kategoritë e tjera buxhetore si pagat dhe shtesat, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale mbesin të njejta.

Investimet kapitale, sipas Tabelës 3.2 tek pjesa projektet kapitale për nivelin qendror do të përfshijnë blerjen e kabinetit dhe UPS-së për serverë, zhvillimin e web-faqes dhe blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative, laptop.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar këtë vit dy ligje të rëndësishme sa i përket çështjeve që lidhen me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit: Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjin nr. 08/L-108 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, për të cilat projektligje në kohën kur janë proceduar në kuvend, sponsorizuesi, në këtë rast Ministria e Drejtësisë përmes vlerësimeve nga ana e Ministrisë së Financa, është deklaruar se miratimi i këtyre ligjeve nuk paraqet kosto shtesë për APK-në, dhe se kjo e fundit mund t'i zbatojë në praktikë të gjitha aktivitetet.

Me Ligjin nr. 08/L-108 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, është bërë një kategorizim i ri i zyrtarëve, në zyrtarë të lartë dhe zyrtarë publikë që do të deklarojnë pasurinë. Ligji i ri ka përfshirë deklarimin e pasurisë të mjekëve dhe profesorëve, të cilët numrin e deklarimeve do ta rrisin nga 4,000 mijë zyrtarë në afër 20,000 zyrtarë.

Viti	2022	2023
Buxheti Vjetor	545,778	557,844
Të punësuarit	43	43
Paga dhe shtesa	413,222	415,288
Mallëra dhe Shërbime	114,056	114,056
Shpenzimet Komunale	8,500	8,500
Subvencione dhe transfere	0	0
Shpenzimet kapitale	10,000	20,000
Rezervat	0	0

Në programin qeverisës të Lëvizjes Vetëvendosje premtohet mbështetje financiare për sistemin e drejtësisë. Kjo, kryesisht, me qëllim të rritjes së kapaciteteve humane dhe profesionale në sistemin e drejtësisë. Rritja e pamjaftueshme e buxhetit për sistemin gjyqësor, ulja e buxhetit për këshillin prokurorial dhe mos ngritja e buxhetit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit flasin për mos përmbushje të premtimeve të paraqitura në programin qeverisës me të cilin partia në pushtet kishte garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit të vitit 2021.

Se si do të përfundojë ndarja finale e buxhetit mbetet të shihet në Kuvendin e Kosovës, ku deputetët do të vendosin nëse drejtësia do të jetë prioritet përmes mbështetjes buxhetore apo përkrahja do të mbetet vetëm premtim.